Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Milaim Sylejmani	**28.07.2026**	**30.07.2026**	**2026/0530**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.07.2026, OE “"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0530, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "N,Sh. Test&Ing Suharek6.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shqyrtimet laboratorike per projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar” me nr. të prokurimit: "622-26-1534-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës:shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt.09.07.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE N.SH. Test&Ing, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. Menaxheri i Projektit i emruar me vendim nuk posedon certifikatën e kërkuar te dëshmitë si në kërkesën dy të kapacitetit teknik dhe profesional në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontrat.
2. Iso Standartet i mungojn (të pa qarta dhe nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara si në dosje të tenderit).
3. Ju mungojn pajisjet teknike si në kërkesën 5 të kapacitetit teknik dhe profesional.

Arsyet e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes së parë të AK-së ku është cekur se Menaxheri i Projektit i emëruar me vendim nuk posedon certifikatën e kërkuar sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional. Ky konstatim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë.

Në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit, ne kemi emëruar z. Fatmir Bajrami si Menaxher

të Projektit, i cili i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara, respektivisht është inxhinier i diplomuar i gjeologjisë, posedon përvojën e kërkuar profesionale, Licencën A, është i trajnuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, si dhe është pjesë e personelit të laboratorit të akredituar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK).

Në ofertën tonë është dorëzuar Certifikata e Akreditimit e laboratorit "IMK BALLKAN PROJEKT" Sh.P.K., së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj. Në pikën 6.2 "Personeli" të dokumentit të akreditimit figuron shprehimisht z. Fatmir Bajrami, M.Sc. i Gjeologjisë, si pjesë e personelit të laboratorit të vlerësuar nga DAK sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018. Dokumenti përfundon me konstatimin zyrtar se laboratori i plotëson kërkesat e pikës 6.2 të këtij standardi, duke konfirmuar se kompetenca e personelit është verifikuar gjatë procesit të akreditimit.
Kërkesa e dosjes nuk ka kërkuar paraqitjen e një certifikate individuale të akreditimit për Menaxherin e Projektit, pasi DAK nuk lëshon certifikata individuale për personelin, por akreditonlaboratorin dhe gjatë këtij procesi vlerëson edhe kompetencën e personelit të tij. Pikërisht për këtë arsye, dokumentacioni zyrtar i akreditimit përmban listën e stafit të vlerësuar, ku figuron edhe z. Fatmir Bajrami.
Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar se cili dokument mungon apo cili kusht nuk është përmbushur nga z. Fatmir Bajrami, por është mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm se ai nuk posedon certifikatën e kërkuar. Një arsyetim i tillë nuk është i bazuar në faktet e ofertës dhe nuk përmbush standardin e arsyetimit të vendimeve administrative. Përderisa operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin që dëshmon se z. Fatmir Bajrami është pjesë e personelit të akredituar nga DAK dhe i plotëson edhe të gjitha kërkesat e tjera të dosjes së tenderit, eliminimi ynë mbi këtë bazë është i pabazuar dhe nuk qëndron.

Autoriteti kontraktues ka interpretuar në mënyrë të gabuar kërkesën e dosjes së tenderit, duke e trajtuar akreditimin e DAK si një certifikatë individuale të Menaxherit të Projektit. Në realitet, sipas sistemit të akreditimit të DAK dhe standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018, akreditimi i jepet laboratorit, ndërsa kompetenca e personelit vlerësohet dhe evidentohet në dokumentacionin zyrtar të akreditimit. Për rrjedhojë, dokumentacioni i dorëzuar nga ne e përmbush plotësisht kërkesën e dosjes së tenderit dhe nuk ekziston bazë ligjore për eliminimin e ofertës mbi këtë arsye.

Duhet sqaruar fakti se për OE të rekomanduar për kontratë, rezulton se për përmbushjen e kësaj kërkese është pranuar vetëm një certifikatë e pjesëmarrjes në trajnim të organizuar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës për standardin SK EN ISO/IEC 17025. Kjo certifikatë dëshmon vetëm ndjekjen e trajnimit dhe nuk përbën certifikatë akreditimi apo dëshmi se personi është vlerësuar dhe kompetent sipas standardit në fjalë. Për rrjedhojë, nëse autoriteti kontraktues ka konsideruar se një certifikatë e pjesëmarrjes në trajnim është e mjaftueshme për përmbushjen e kësaj kërkese, atëherë nuk ka asnjë bazë ligjore që operatori ynë ekonomik të eliminohet, përderisa ka dorëzuar dokumentacion edhe më të plotë dhe më bindës.

Autoriteti kontraktues tek arsyeja e dytë për eliminimin tonë ka dhënë arsyetimin se: *"ISO Standardet i mungojnë (të pa qarta dhe nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara si në dosje të tenderit)."*

Kjo arsye e eliminimit është e paqartë dhe e pabazuar, pasi ne kemi dorëzuar të gjitha certifikatat ISO të kërkuara në dosjen e tenderit, të cilat janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara nga AK-ja.
Autoriteti kontraktues në arsyen e saj për eliminimin tonë nuk ka specifikuar se në çfarë konsiston arsyetimi se certifikatat "i mungojnë", janë "të paqarta" apo "nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara", duke e bërë të pamundur identifikimin e ndonjë mangësie konkrete në

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur çfarëdo dileme lidhur me certifikatat e dorëzuara, ai ka mundur, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime nga ne si operator ekonomik ose të verifikojë drejtpërdrejt vlefshmërinë e tyre pranë kompanisë që i ka lëshuar këto certifikata. Duke mos i shfrytëzuar dispozita ligjore dhe duke u mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm e të paargumentuar, AK-ja ka nxjerrë një përfundim të pabazuar në gjendjen faktike dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga ne dhe njëkohësisht na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues na ka eliminuar tek arsyeja e tretë me arsyetimin: *"Ju mungojnë pajisjet teknike si në kërkesën 5 të kapacitetit teknik dhe profesional."*

Ky arsyetim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga ne. Në përputhje me Kërkesën 5 të Dosjes së Tenderit, ne kemi dorëzuar listën e mjeteve të punës, të nënshkruar, me dëshmitë të cilat janë kërkuar nga AK-ja, përmes të cilave vërtetohet fakti se pajisjet e prezantuara nga ana jonë, janë në harmoni me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Autoriteti kontraktues nuk ka specifikuar se cilat pajisje teknike pretendohet se mungojnë apo se cila kërkesë konkrete nuk është përmbushur, prandaj një arsyetim i tillë është i përgjithshëm, i paqartë dhe nuk mbështetet në asnjë fakt apo provë konkrete.

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi ose dilemë lidhur me listën e pajisjeve të dorëzuara apo dokumentacionin përkatës, ai ka mundur, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime nga ana jonë përpara marrjes së vendimit për eliminim, por që një veprim të tillë nuk e ka ndërmarr, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke mos kërkuar sqarime dhe duke mos identifikuar konkretisht se cilat pajisje pretendohet se mungojnë, autoriteti kontraktues ka nxjerrë një përfundim të pabazuar, i cili nuk mbështetet në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk mund të përbëjë bazë ligjore për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit.

Ne me dt.15.07.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë fakte konkrete për një refuzim të tillë.

Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk i trajton në mënyrë konkrete pretendimet tona ankimore dhe nuk i kundërshton faktet e paraqitura nga ne, por vetëm i përsërit arsyet e eliminimit të dhëna më parë në njoftimin mbi vendimin e AK-së.

Sa i përket pretendimit lidhur me Menaxherin e Projektit, autoriteti kontraktues është mjaftuar me konstatimin se nuk është paraqitur dëshmia apo certifikata e kërkuar, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka mundur të argumentoj me fakte konkrete se pse dokumentacioni i dorëzuar nga ne nuk është konsideruar i mjaftueshëm. Ne kemi paraqitur dokumentacionin përmes të cilit dëshmohet se menaxheri i projektit është pjesë e personelit të laboratorit të akreditуar dhe i njëjti i plotëson kushtet e kërkuara sipas dosjes së tenderit. Në vend që t'i analizojë këto dokumente dhe t'i kundërshtojë me argumente konkrete, AK-ja është mjaftuar vetëm me përsëritjen e konstatimit se dëshmia nuk është e mjaftueshme. Një arsyetim i tillë nuk e rrëzon pretendimin tonë dhe nuk sqaron se ku qëndron mangësia konkrete në ofertën tonë. AK-ja e ka cekur se nuk mund të nuk mund të pranohen dëshmi alternative, mirëpo një gjë e tillë është e paqëndrueshme sepse dëshmitë e prezantuara nga ana jonë nuk janë alternative, por janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit.
Duhet cekur fakti se ne kemi argumentuar se Drejtoria e Akreditimit e Kosovës nuk lëshon

certifikata individuale për personelin, por akrediton laboratorin dhe gjatë procesit të akreditimit vlerëson kompetencën e personelit sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018. Pikërisht për këtë arsye në certifikatën dhe aneksin e akreditimit figuron z. Fatmir Bajrami si personel i laboratorit të akreditуar, por që ky pretendim i yni nuk është trajtuar fare në vendimin për refuzim. AK-ja nuk ka prezantuar asnjë provë, asnjë referencë nga DAK apo nga standardi ISO 17025 që e kundërshton këtë fakt, por është mjaftuar vetëm me konstatimin se dokumenti ynë "nuk zëvendëson certifikatën".

Po ashtu, AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete lidhur me pretendimin tonë se operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë i është pranuar dokumentacion i cili, sipas vlerësimit tonë, nuk dëshmon përmbushjen e të njëjtës kërkesë në mënyrën se si është interpretuar ndaj nesh. Në vend që ta analizojë këtë pretendim dhe të japë sqarime konkrete, AK-ja është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se secila ofertë vlerësohet individualisht, pa shpjeguar se si është bërë vlerësimi në rastin konkret, veprim ky që tregon qartë se autoriteti kontraktues po e favorizon OE të rekomanduar për kontratë dhe se me këto veprime të AK-së ne nuk mund të krijojmë përshtypje tjetër përveç se faktit që ky tender është i përgatitur për këtë operator ekonomik.

Edhe lidhur me pretendimin tonë ankimor sa i përket standardeve ISO, vendimi për refuzim nuk përmban asnjë argument konkret që e dëshmon të kundërtën e pretendimit tonë ankimor. AK-ja në vendimin për refuzim pretendon se dokumentacioni është i paqartë dhe nuk mundëson verifikimin e plotë të përmbushjes së kërkesave, mirëpo nuk specifikon se cila certifikatë mungon, cili standard nuk është përmbushur apo cili dokument është konsideruar i paqartë. Një arsyetim i tillë i përgjithshëm nuk mund të konsiderohet si vlerësim i mirëfilltë i ofertës, pasi nuk identifikon asnjë mangësi konkrete në dokumentacionin e dorëzuar nga ne.

E njëjta situatë paraqitet edhe tek pretendimi lidhur me pajisjet teknike, ku edhe këtu AK-ja pretendon se nuk janë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për pajisjet e kërkuara, mirëpo nuk tregon se për cilën pajisje mungon dokumentacioni, cilën kërkesë konkrete nuk e kemi përmbushur apo cili dokument nuk është paraqitur. Në mungesë të një identifikimi të qartë të mangësive të pretenduara, arsyetimi i AK-së mbetet vetëm një konstatim i përgjithshëm dhe jo një vlerësim i bazuar në fakte konkrete.

Në fund theksojmë se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk përmban një analizë të mirëfilltë të pretendimeve tona ankimore, por kryesisht i përsërit arsyet e eliminimit. Në disa pika, autoriteti kontraktues ka bërë shmangie nga pretendimet tona konkrete, pa iu përgjigjur argumenteve dhe fakteve që kemi paraqitur në kërkesën për rishqyrtim. Prandaj vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, është i pa bazuar dhe jo profesional për faktin se në asnjë mënyrë nuk janë ofruar fakte konkrete të bazuara në dispozita ligjore për eliminimin e ofertës sonë.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së që të analizojnë në detaje pretendimet tona ankimore dhe njëkohësisht edhe arsyetimin e autoritetit kontraktues dhe pastaj të nxjerret një vendim meritor në lidhje me pretendimet tona.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë

dhe me çmim më të lirë.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne edhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ne edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov. net	**1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të**

B05 Njoftim per Kontrat 4 / 8

	LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **Kërkesa 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2 OE duhet të jetë i Regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH-së Kërkesa 3 Regjistrimi i Numrit Fiskal**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Dëshmia 2 Certifikata e TVSH-kopje. Dëshmia 3 Certifikata e numrit fiskal-kopje**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (2023.2024,2025) ka qen prej jo më pak se 300.000,00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Pasqyrat financiare të OE, te shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2023,2024,2025) apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 225.000,00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të sherbimeve.**
Kerkesa 2. Te posedoj akreditim nga DAK per testime fiziko-mekanike si; Beton I njome dhe I ngurtesuar , parafabrikuatet e betonit, agregatet , asfaltet dhera. - Armature shufra vetite mekanike dhe - Pilota (testimi I integritetit Kerkesa 3. Ne kuader te stafit duhet te caktohet a. Menaxheri I projektit I cili duhet te jete inxhnier I diplomuar I gjeologjis me jo me pak se 5 vite pune ne profesion te jete I licensuar me licenc A te posedon akreditimin nga DAK.Kerkesat e pergjithshme për kopetencat te laboratoreve testuese dhe kalibruese. Te jete i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë.	**Deshmit ; 2. Kopja e Licences se Akreditimit nga DAK(departamenti i akreditimit te Kosoves)se bashku me Aneksin e Akreditimit. Dëshmia 3; Duhet te caktohet me vendim menaxheri i projektit ,CV-ja e firmosur nga vet Inxhinieri,kopja e diplomës, te posedon Licencen A nga MMPHI,, deshmi mbi pervojen e punes, Kontrata e punes ose e bashkepunimit per kete projekt. Certifikata personale e akreditimit nga DAK, te jete ne emer te personit jo ne emer te kompanis, certifikata e trajnimit per siguri dhe shendet ne pune.**
b- Një (1) Inxhinier I diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master drejtimi konstruktiv , me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit. c.Te kete se paku 5 te punesuar me profile te ndryshme adekuate per realizimin e kontrates	**deshmia b. Cv e firmosur nga vete inxhinieri kopja e diplomes, deshmi mbi pervojen ne pune , kontrata e punes ose bashkepunimit per kete projekt me Oe ne fjale. c.Lista e stafit profesional te punesuar kontrata e punes ose marreveshje bashkepunim per kete projekt bashke me pershkrimin e vendit te punes.**

Kerkesa 4. Te posedoj certifikata ISO ; 9001 2015 ; 14001; 2015 ; 45001; 2018	**Dëshmia 4; kopjet e certifikatave ISO duhet te jene te verifikusheme per Ak përmes linkut online.**
Kerkesa 5 – OE duhet ta ofroje listen mbi mjetet e punes e nenshruar nga OE me pajisjet ne vijim 1 Kamion per bartjen e automjeteve (makineri e shpimit – testimit) me beshe bartese min 8 t.) - Kamion special per shpimin (sonde	**Deshmi 5 - OE duhet te ofrojë listën e pajisjeve te kërkuara për ekzekutimit të punëve e vulosur dhe nënshkruar. Për pajisjet qe i merre ne shfrytezim O.E duhet te kete marreveshje ne emer te ketij projekti . Për mjetet qe**

shpimi) min 6 t - Nje riciklues asfalti deri 10 litra - Furre per djegje te asfaltit 999 C - Pllak magnetike -asfalt 2cop - Furre minimum 3 cop - Presa marshall 0-50 km dhe kompaktori - Sklerometri 1 cop - Vibratory 3 cope - Vibro tavolina 2 cope - Slump test - Vebe test - Sitat tavolina vibruese 1 cop - Pllaka dinamike 2 cope - Paisje per ngrirje dhe shkrirje (frigo digjitale) -Paisje per caktimin e peshes vellimore ne teren - Makineri te shpimit te asfaltit min 2 cop - Peshore hidrostatike DCP test - Paisje per matjen e integritetit te pilotave	**regjistrohen duhet te dorezohen lejet e qarkullimit me validitet ndersa per mjetet qe nuk regjistrohen dudi doganor apo fatura e shitblerjes.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Procedura e hapur
Procedurë e hapur; Vlerë e madhe

Në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data kur është përgatitur Raporti i Vlerësimit: **09.07.2026**

Nr. i prokurimit [1]	**622-26-1534-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Titulli: Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË ADMINISTRATIVE të TENDERËVE

Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik

	Identifikimi i qartë i tenderuesit			Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit						
	TENDERUESI (Emri, Adresa, Numri fiskal)	Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik	**Deklaratë e gartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	**Deklaratë e nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	**Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet**	**Origjinali i tenderit dhe kopje**		**Sigurimi i tenderit në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit**	**Vlefshmëria e tenderit** 120 ditë / muaj / data deri	**Deklaratë** e cila deklaron nënkontraktuesin e zgjedhur	**Kërkesa të tjera formale/administrative** *(të specifikuara)*	**TENDERI I PËRGJEGJSHËM ME KËRKESAT ADMINISTRATIVE** PO/JO
1.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. Llapnaselle, Gracanice 810142480				Jo	Jo	Jo		ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Jo
2.	N.SH. TEST&ING Suharekë, Kosovë 600477998				Po	Po	Po		150 ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Po

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

2

3.	,GEOKOS A & A O.P Arkitekt Karl Gega 8, Prishtine 811340538			Jo	Jo		ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Jo
4.	ZLine Company SH.P.K. De Rada, Lam.I/A-1, Prizren 812238526			Jo	Jo		ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Jo
5.	HARST Group SH.P.K. Harstgroup, Suharekë 810025090			Jo	Jo		ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Jo

3

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

Siguria e tenderit

	TENDERUESI	Forma e sigurisë së tenderit	Vlera e sigurise së tenderit	Sigurimin e tenderit të vlefshëm derime	Emetuesi e sigurisë së tenderit	Informacione të tjera në lidhje me sigurimin e tenderit
1.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. Llapnaselle, Gracanice 810142480					
2.	N.SH. TEST&ING Suharekë, Kosovë 600477998	Bondi te sigurisë, të lëshuar nga një kompanie sigurimit	2,000.00 EUR	02.10.2026		
3.	,GEOKOS A & A O.P Arkitekt Karl Gega 8, Prishtine 811340538					
4.	ZLine Company SH.P.K. De Rada, Lam.I/A-1, Prizren 812238526					
5.	HARST Group SH.P.K. Harstgroup, Suharekë 810025090					

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E PRANUSHMËRISË

Dokumenti	,GEOKOS A & A O.P	N.SH. TEST&ING	ZLine Company SH.P.K.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.	HARST Group SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesat 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov. net	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë e pranushmërisë:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRISË PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	,GEOKOS A & A O.P	N.SH. TEST&ING	ZLine Company SH.P.K.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.	HARST Group SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2 OE duhet të jetë i Regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH-së Kërkesa 3 Regjistrimi i Numrit Fiskal	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë profesionale:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR GJENDJEN EKONOMIKE & FINANCIARE

Dokumenti	,GEOKOS A & A O.P	N.SH. TEST&ING	ZLine Company SH.P.K.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.	HARST Group SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (2023.2024,2025) ka qen prej jo më pak se 300.000,00 €	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare:



caktimin e peshes vellimore ne teren - Makineri te shpimit te asfaltit min 2 cop - Peshore hidrostatike DCP test - Paisje per matjen e integritetit te pilotave

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

9

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	,GEOKOS A & A O.P	N.SH. TEST&ING	ZLine Company SH.P.K.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.	HARST Group SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 225.000,00 €	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm
Kerkesa 2. Te posedoj akreditim nga DAK per testime fiziko-mekanike si; Beton I njome dhe I ngurtesuar , parafabrikuatet e betonit, agregatet , asfaltet dhera. - Armature shufra vetite mekanike dhe - Pilota (testimi I integritetit Kerkesa 3. Ne kuader te stafit duhet te caktohet a. Menaxheri I projektit I cili duhet te jete inxhnier I diplomuar I gjeologjis me jo me pak se 5 vite pune ne profesion te jete I licensuar me licenc A te posedon akreditimin nga DAK.Kerkesat e pergjithshme për kopetencat te laboratoreve testuese dhe kalibruese. Te jete i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë.	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm
b- Një (1) Inxhinier I diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master drejtimi konstruktiv , me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit. c.Te kete se paku 5 te punesuar me profile te ndryshme adekuate per realizimin e kontrates	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm
Kerkesa 4. Te posedoj certifikata ISO ; 9001 2015 ; 14001; 2015 ; 45001; 2018	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm
Kerkesa 5 – OE duhet ta ofroje listen mbi mjetet e punes e nenshruar nga OE me pajisjet ne vijim 1 Kamion per bartjen e automjeteve (makineri e shpimit – testimit) me beshe bartese min 8 t.) - Kamion special per shpimin (sonde shpimi) min 6 t - Nje riciklues asfalti deri 10 litra - Furre per djegje te asfaltit 999 C - Pllak magnetike -asfalt 2cop - Furre minimum 3 cop - Presa marshall 0-50 km dhe kompaktori - Sklerometri 1 cop - Vibratory 3 cope - Vibro tavolina 2 cope - Slump test - Vebe test - Sitat tavolina vibruese 1 cop - Pllaka dinamike 2 cope - Paisje per ngrirje dhe shkrirje (frigo digjitale) - Paisje per	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm



caktimin e peshes vellimore ne teren - Makineri te shpimit te asfaltit min 2 cop - Peshore hidrostatike DCP test - Paisje per matjen e integritetit te pilotave

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

9

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lënda / grupi: Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	N.SH. TEST&ING, 600477998	148,782.50

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	N.SH. TEST&ING, 600477998	50000	Suharekë

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

11

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

1.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. 810142480	
2.	N.SH. TEST&ING 600477998	
3.	,GEOKOS A & A O.P 811340538	
4.	ZLine Company SH.P.K. 812238526	
5.	HARST Group SH.P.K. 810025090	

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

Analiza e çmimit

	TENDERUESI	Informata në lidhje me gabimet ne llogaritje	Arsyet për refuzimin e tenderit për shkak të çmimit anormalisht të ulët
1.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. 810142480		
2.	N.SH. TEST&ING 600477998		
3.	,GEOKOS A & A O.P 811340538		
4.	ZLine Company SH.P.K. 812238526		
5.	HARST Group SH.P.K. 810025090		

Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit

	TENDERUESI	Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit
1.	"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. 810142480	
2.	N.SH. TEST&ING 600477998	
3.	,GEOKOS A & A O.P 811340538	
4.	ZLine Company SH.P.K. 812238526	
5.	HARST Group SH.P.K. 810025090	

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE Ankues është palë me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.**

PRETENDIMI -1 i Operatorit Ekonomik: Ka të bëjë me Kërkesën nr 2. të kapacitetit teknik dhe profesional, me çështjen e akreditimit të Kompanisë, gjegjësisht akreditimin personal të menaxherit të projektit, e që sipas AK me dëshmitë e ofruara nuk është plotësuar ky kriter.

Përgjigje e AK në pretendimin - 1:

Dosja e Tenderit ka përcaktuar kërkesë konkrete për Menaxherin e Projektit dhe dëshminë/certifikatën përkatëse. OE ka qenë i obliguar që, brenda afatit për dorëzimin e tenderëve, të paraqesë pikërisht dëshminë e kërkuar dhe jo dokumente të tjera që vetëm në mënyrë të tërthortë lidhen me personelin e laborantit.

Certifikata e akreditimit të laborantit dhe përfshirja e z. Fatmir Bajrami në listën e personelit të laborantit dëshmojnë statusin e laborantit dhe evidencimin e personelit në kuadër të procesit të akreditimit. Ato nuk zëvendësojnë automatikisht certifikatën ose dëshminë individuale të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit për Menaxherin e Projektit. Akreditimi i laborantit dhe plotësimi i një kriteri individual të kualifikimit janë çështje të dallueshme dhe vlerësohen sipas formulimit të kërkesës së publikuar.

Komisioni Vlerësues nuk ka të drejtë të ndryshojë pas hapjes së ofertave kuptimin e një kërkese të qartë të Dosjes së Tenderit, as të pranojë një dëshmi alternative që nuk demonstron në mënyrë të drejtpërdrejtë përmbushjen e saj. Prandaj, konstatimi se Menaxheri i Projektit nuk posedon dëshminë/certifikatën e kërkuar mbetet i qëndrueshëm.

Krahasimi me dokumentacionin e OE të rekomanduar nuk e bën ofertën e parashtruesit të përgjegjshme. Secila ofertë vlerësohet individualisht kundrejt kërkesave të publikuara. Nga rishqyrtimi nuk është konstatuar trajtim i ndryshëm i situatave të njëjta, por zbatim i të njëjtave kërkesa ndaj secilit tenderues.

Konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për pretendimin e 1-të:

Eksperti Shqyrtues, vjen në përfundim se AK ka kërkuar akreditim personal nga DKA për menaxherin e Projektit, ani se nëLIGJI Nr. 05/L -117 PËR AKREDITIM1 neni 7- nga shtatë fusha të aktivitetit të akreditimi, nuk është paraparë që DKA të bëjë akreditim personal. Akreditimi është dhënë për OE ankues nga DKA, me komplet stafin dhe mjetet / pajisjet e nevojshëm për akreditim, rrjedhimisht ky kriter është i plotësuar.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së është i bazuar, rekomandohet rishqyrtimi ose heqja e këtij kriteri.

PRETENDIMI -2 i Operatorit Ekonomik: Ka të bëjë me eliminimin e OE ankues për shkak të mos plotësimit të standardeve ISO , dhe me cilësimin nga AK se certifikatat e OE ankues janë të paqarta, dhe nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara.

Përgjigje e AK në pretendimin – 2, lidhur me standardet ISO:

Pretendimi se janë dorëzuar të gjitha certifikatat ISO nuk mbështetet nga një dëshmi e qartë dhe e plotë se secili standard i kërkuar është paraqitur në formën, fushëveprimin, vlefshmërinë dhe për subjektin e kërkuar në Dosjen e Tenderit. Dokumentet e paraqitura janë vlerësuar të paqarta dhe nuk mundësojnë verifikimin e plotë të përmbushjes së kërkesës.

Në prokurim publik, barra për të dëshmuar përmbushjen e kërkesave të kualifikimit i takon tenderuesit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të supozojë përmbushjen e një kriteri, as të plotësojë vetë përmbajtjen që nuk rezulton qartë nga dokumentacioni i tenderit. Për rrjedhojë, arsyeja e eliminimit lidhur me standardet ISO është e bazuar.

Konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për pretendimin e 2-të:

OE ka ofruar Ceertifikata ISO ashtu sic janë kërkuar në dosjen e tenderit, përkatësisht: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionalë pika 9.1 dhe 9.2 kërkesa nr 4: certifikatat ISO 9001 : 2015, ISO14001:2015, dhe Iso 45001:2018.OE ankues ka ofruar të gjitha këto certifikata dhe AK duhet të veproj në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së ankues është i qëndrueshëm.

PRETENDIMI -3 i Operatorit Ekonomik: Autoriteti kontraktues na ka eliminuar tek arsyeja e trete me arsyetimin: *"Ju mungojnë pajisjet teknike si ne kërkesën 5 te kapacitetit teknik dhe profesional."*

Përgjigje e AK në pretendimin - 3: Lista e mjeteve e nënshkruar, pa dëshmi të plota dhe të verifikueshme për disponueshmërinë, posedimin ose të drejtën e përdorimit dhe pa dokumente që

tregojnë pajtueshmërinë e secilës pajisje me karakteristikat e kërkuara, nuk mjafton për të provuar kapacitetin teknik dhe profesional. Nga rishqyrtimi i dokumentacionit është vërtetuar se oferta nuk përmban dëshmi të mjaftueshme për të gjitha pajisjet e kërkuara sipas Kërkesës 5. Kjo përbën mangësi përmbajtjesore në dëshmimin e kapacitetit teknik dhe profesional dhe jo vetëm paqartësi formale. Prandaj, pretendimi i OE refuzohet si i pabazuar.

Konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për pretendimin e 3-të:

Ashtu siç janë kërkuar dëshmitë në dosjen e tenderit për listën e mjeteve të punës, OE ka ofruar Listën e nënshkruar dhe të vulosur të pajisjeve të kërkuar për ekzekutimin e punëve. Ka ofruar marrëveshje të qiramarrjes për mjetet që nuk i posedon, ka ofruar libreza te regjistrimit për mjete që regjistrohen, dhe ka ofruar DUD- at doganorë apo faturat e shitblerjes.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së ankues është i qëndrueshëm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në konstatimet e lartëshënuara, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE IMK Ballakn Projekt SH.P.K. të aprovohet si e bazuar, të anulohet Njoftimi për Dhënie të Kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.**

Milaim Sylejmani